



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 894/6 prot.

Tiranë, më 15.12.2020

VENDIM
Nr.181, datë 15.12.2020

PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 160, DATË 25.11.2020, NË INSTITUCIONIN
AGJENCIA RAJONALE E SHËRBIMIT VETERINAR DHE MBROJTJES SË
BIMËVE TIRANË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 160, dt. 25.11.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”*, ku shprehimisht është kërkuar: *“Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”*, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, institucion varësie i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 3817/1 prot., datë 05.06.2020, nga ana e Ministrisë është raportuar, ndër të tjera, në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik në Agjencinë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, vendimin paralajmërues me Nr. 160, dt. 25.11.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, me shkresën nr. 481/1 prot., datë 01.12.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrtur Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit:

- ***** , në pozicionin e punës *“Përgjegjës në Sektorin e Shërbimit Veterinar Durrës”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Specialist në Sektorin e Shërbimit Veterinar Tiranë”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Specialist në Sektorin e Shërbimit Veterinar Tiranë”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Specialist në Sektorin e Shërbimit Veterinar Durrës”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*

dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 160, dt. 25.11.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha